



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 45/19  
Prishtinë, më 27.2.2019, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Arbërie Nagavci, Ali Lajçi, Dardan Molliqaj, Enver Hoti, Blerim Kuqi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontiq.

Pjesëmarrës i ftuar: Ismet Krasniqi - Sekretar i Përgjithshëm i Administratës së Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu – Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Administratës në Kuvendin e Kosovës, Istret Azemi - Dretor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa të Administratës në Kuvendin e Kosovës.

Pjesëmarrës tjerë: Kreshnik Ymeri - monitoruese nga KDI, Emirjeta Vllahu – Gazetare nga Kallco.com, Leonard Berbatovci - Gazetar nga RTK, Arëbresha Shpati- Gazetare nga Klan Kosova.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 13.02.2019;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari:** Siç jeni njoftuar nga stafi përmes email-it, propozojë që rendi i ditës të plotësohet me një pikë të re: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Kryetari konstatoi Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës me plotësimin e një pike shtesë e katërt me radhë: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

## 2. Miratimi i pocesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 13.02.2019

**Kryetari:** Konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi pocesverbalin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 13.02.2019, pa vërejtje.

## 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018

**Kryetari:** Ja kaloi fjalën Sekretarit të Kuvendit të prezantojë Raportin vjetor të shpenzimeve për vitin 2018.

**Ismet Krasniqi:** Theksoi se në total Kuvendi për vitin 2018 ka shpenzuara 8,851,012.96 euro. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 6,837,000 euro apo 100%, për mallra dhe shërbime 1,551,315 euro apo 70%, shpenzimet komunale 179,444 euro apo 91%, subvencione dhe transfere 123,312 euro ose 100% dhe për investime kapitale 154,491 euro apo 79%.

Tek pjesa e mallrave dhe shërbimeve, mjetet e ndara për shënimin e pavarësisë prej 100,000 euro nuk janë shpenzuara. Po ashtu 80,000 euro të parapara për auditimin e partive politike nuk janë shpenzuar si dhe shuma e ndarë për diplomaci parlamentare prej 200,000 euro nuk është shpenzuar. Ndërsa mjete e ndara për komisionet parlamentare kanë mbetur të kursyera në shumë prej 82,000 euro.

Sa i përket shpenzimeve kapitale, buxheti i shpenzuar është më i ulët se buxheti fillestare, mirëpo në fund të vitit i kemi nënshkruar disa kontrata si: për projektin e renovimit të ndërtesës 202,000 euro, projekti qendra e të dhënave në shumë prej 449,000 euro që është projekt për 3 vite, E parlamenti shuma është 169,000 eurove, digjitalizimi i arkives në shumë prej 90,000 euro, që do të realizohen në vitin 2019 dhe 2020.

**Kryetari:** Sa i përket subvencioneve dhe transfereve, zoti Sekretar thatë se janë shpenzuar 128,000 euro, a keni një listë të subvencioneve se kujt janë dhënë dhe mbi çfarë baze janë shpërndarë? Për këtë kategori keni edhe rekomandim nga Auditori Gjeneral i cili thotë: Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se dhënia e subvencioneve duhet të ketë një monitorim të qartë. A është përmbushur kjo kërkesë e auditorit dhe a mundemi me pas një pasqyrë të qartë të realizimit të tyre?

**Ismet Krasniqi:** Në pjesën e raportit janë të dhënat dhe lista e subvencioneve për tremujorin e katërt të vitit 2018. Subvencionet është një kategori nën autoritetin e Kryesisë së Kuvendit dhe realizimi i atyre mjeteve bëhet në përputhje me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve. Sa i përket Auditorit të Jashtëm, në kohën kur është bërë auditimi nuk ka pas raporte kthyese nga përfituesit për dy subvencione që janë dhënë. Në bazë të Rregullores është një afat prej 60 ditësh ku kërkohet nga personi që ka përfituar subvencionin të dorëzojë një raport për mënyrën e realizimit të shpenzimeve. Në kohën kur ka qenë auditori nuk ka pasur raporte kthyese, ndërsa në ndërkohë janë kryer ato raporte për dy projektet e subvencionuara dhe është njoftuar Zyra e Auditorit të Jashtëm.

**Kryetari:** Pyetja ime e dytë ka të bëjë me kapitullin numër 13, dhe në tabelë ka mospërputhje me të dhënat në tabelën me numër 10 që ka të bëjë me stafin mbështetës politik, përkatësisht me shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, për vitin 2018, sa a janë numrat e saktë?

**Ismet Krasniqi:** Sqaroi se të dhënat detale janë për tremujorin e katërt të vitit, ndërsa shpenzimet sipas kategorive dhe programeve janë prezantuar në total. Por ne mund të përgatisim një raport shtesë me të dhënat detale për gjithë vitin 2018.

**Kryetari:** Lidhur me udhëtimet jashtë vendit të deputetëve, për tremujorin e katërt apo për tre muaj, për bileta janë shpenzuar 46,000 euro, për mëditje 32,000 euro, për akomodime 20,000 euro, që në total bëjnë 90,000 euro të shpenzuara për 120 deputet për udhëtimet jashtë vendit. Ndërkaq, shpenzimet e

stafit mbështetës politik, për tre muaj, për bileta janë shpenzuar 28,000 euro, për mëditje 16,000 euro, për akomodime 12,000 euro, dhe në total janë 60,000 euro.

Pra, të gjithë deputetët e Kuvendit pre tre muaj, i kanë shpenzuar 90,000 euro, kurse stafi mbështetës politik, që 90% janë shpenzime të Kryetarit dhe kabinetit të tij, përpos tri grupeve tjera parlamentare, ka shpenzuar 60,000 euro, që është një mospërputhje absurde!

P.sh. në udhëtimin që ka realizuar Kryetari Kuvendit në SHBA, Bruksel, Gjermani dhe udhëtimet tjera kanë marrë pjesë edhe 5 staf të tij. Ajo që më intereson është kush vendos për lejimin e këtyre udhëtimeve jashtë vendit me numrin kaq të madhë të pjesëmarrësve, që mua më duken më shumë si ekskursione?

**Ismet Krasniqi:** Sqaroi se shpenzimet e stafit mbështetës politik janë realizuara në bazë të vendimeve të Kryesisë së Kuvendit dhe sipas formatit të kërkesës që shkon dhe miratohet në Kryesi.

**Dardan Molliqaj:** Pyeti a shkon në Kryesi edhe numri i pjesëmarrësve të vizitës apo vetëm formati. Pra a propozohet e gjithë lista e pjesëmarrësve apo thuhet vetëm vizitë e Kryetarit së bashku me stafin e tij?

**Ismet Krasniqi:** Sqaroi se në Kryesi merret vendimi për lejimin e vizitës, që përfshinë destinimin e vizitës zyrtare, tema dhe formati i delegacionit, por jo edhe numri.

**Dardan Molliqaj:** Unë besojë se duhet konstatuar si komision se janë shpenzime të mëdha ato që ka bërë Kryetari i Kuvendit me stafin tij, për tre muaj. E di që këto shpenzime nuk janë nën përgjegjësin tuaj si sekretar, por janë shpenzime të mëdha dhe vërejtjet duhet me ia adresu Kryetari të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit bënë përfaqësim diplomatik në vendet tjera dhe nuk është detyrë e tij me lobue.

Më pas z. Molliqaj pyeti lidhur me shpenzimeve për paga dhe mëditje, a janë të dhënat e sakta dhe si është e mundur me u shpenzue 100% e buxhetit të planifikuar për mëditje? Po ashtu u interesua, përveç pagave, sa janë shpenzuar për mëditje, pasi që kategoria quhet “paga dhe mëditje”? A paguhen mëditjet prej kësaj pjese apo nga mallrat dhe shërbimet? Nëse paguhen nga mallrat dhe shërbimet duhet rregulluar emërtimi i kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

**Ismet Krasniqi:** Sqaroi se mëditjet paguhen nga mallrat dhe shërbimet.

**Arbërie Nagavci:** Kam një pyetje dhe dy kërkesa. Tek pagat dhe mëditjet është rritur vlera më shumë se 900,000 euro, a janë të punësuar persona të rinjë edhe pse është kjo rritje? Lidhur me dy çështje tjera, atë që i shtroi edhe kryetari i komisionit, a mund të kemi një listë të vendimeve të udhëtimeve jashtë vendit, kryesisht të stafit politik, që përfshin emrat e personave dhe vendimet e Kryesisë që janë marrë?

Ju jeni dëshmitar se komisioni i arsimit me një udhëtim në Bruksel ka paraqitur kërkesën në Kryesi për 4 personave dhe Kryesia në mënyrë arbitrare ka vendos me emër që vetëm njëri nga deputetët të marrë pjesë dhe kjo ka ndodhur vetëm për faktin se ka qenë i VV-së. Po ashtu kam një kërkesë që ta kemi një listë të detajuar për shpërndarjen e subvencioneve dhe vendimeve që janë marrë për ato subvencione. Një pyetje tjetër të natyrës administrative, meqenëse mbi 106,000 euro janë shpenzuar për blerjen e lloptopëve për deputetëve, a është planifikuar heqja e letrës nga përdorimi dhe nëse po, kur do të ndodh kjo?

**Ismet Krasniqi:** Sqaroi se deri në muajin maj 2018 janë raportuar edhe pagat shtesë për deputetët të pa zgjedhur dhe të pa sistemuar në punë, siç e përcakton ligji. Sa i përket pyetjes për zëvendësimin e letrës, theksoi se materialet deputetët do ti kenë në formë elektronike. Pra nuk do të fotokopjen 120 kopje për një projektligj, kopjet fizike do të bëhen për anëtarët e komisionit funksional, ndërsa deputetët do të kenë projektligjin dhe materialet përcjellëse në adresat elektronike. Por është edhe një problem në këtë drejtim se një numër i deputetëve akoma nuk ka hapur adresës zyrtare elektronike.

**Blerim Kuqi:** Për mua është me rëndësi me i pa rekomandimet e Auditorit për vitin 2018 dhe nivelin e implementimit të tyre, të cilat nuk i kam parë të bashkangjitura këtij raporti. Lidhur me subvencionet, a ka ndonjë rregullore apo akt juridik ose kritere e cila është në fuqi, për ndarjen e subvencioneve? Sa i përket shpenzimeve të Kryetarit të Kuvendit dhe stafit të tij për udhëtime jashtë vendit, kur kihet parasysh faktin se është niveli numër 2 i shtetit dhe për rëndësinë e institucionit që përfaqëson, shpenzimet e ndodhura nuk janë shumë. Ne i kemi parë raportet financiare të ministrive dhe agjencioneve tjera shtetërore se sa shpenzime kanë bërë, prandaj duhet bërë krahasime edhe ato. Shifet se është një efikasitet më i madh i shpenzimeve në vitin 2018, krahasuar me një vit më parë, por do të ishte shumë e nevojshme për të parë raportin e Auditorit për të vlerësuar këto shpenzime.

**Ismet Krasniqi:** Sa i përket Auditorit Gjeneral i keni të bashkangjitur rekomandimet e tij për vitin 2017. Kuvendi i Kosovës nuk ka pasur më tepër se 4 rekomandime në kontinuitet nga auditori dhe zbatimi i rekomandimeve është 100%, dhe ka pjesërisht rekomandime të cilat nuk kthehen mbrapa por që çështjet në të ardhmen mos me u përsëritë dhe me krenari themë se jemi shumë mirë si institucion në relacion me auditimin e jashtëm. Sa i përket subvencioneve, thashë edhe më herët, Kryesia ka miratuar Rregulloren për subvencione, ku janë të përcaktuara edhe kriteret për shpenzimin e tyre dhe këto kritere përcaktojnë se deri në 5,000 euro mund të ndahen si subvencion kur përfiton komuniteti, ndërsa deri 20,000 euro si bashkëpjesëmarrje në ndonjë projekt që mbështetet Kuvendit nga ndonjë organizatë apo institucion tjetër. Çdo shpenzim i subvencioneve është i mbuluar me një vendim të Kryesisë.

**Kryetari:** Pyeti sekretari, sa staf mbështetës ka Kryetari i Kuvendit?

**Ismet Krasniqi:** Në pyetjen e kryetarit të komisionit, tregoi se kryetari i kuvendit, ka dikun 17 staf mbështetës politik.

**Kryetari:** Z. Kuqi, Kryetari i Kuvendit i ka 17 staf mbështetës, e kurse deputetët e Kuvendit janë 120 dhe nëse i krahasojmë shpenzimet për tre muaj, Kryetari i Kuvendit me stafin e tij ka shpenzuar 60,000 euro, që për një muaj i bie 20,000 euro shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit dhe mua më duken shumë. Nëse ka kuptim kush duhet me shkue në udhëtime jashtë vendit në përfaqësimin e Kuvendit, janë deputetë dhe jo stafi mbështetës politik.

**Blerim Kuqi:** Theksoi se nuk po dua me mbrojte Kryetarin e Kuvendit, por duke ditur pozicionin dhe duke krahasuar me institucionet tjera, që bëjnë shpenzime shumë më të mëdha, vlerësojë se shpenzimet e Kryetarit nuk janë të larta. Ajo që është me rëndësi për analizë dhe shqyrtim janë natyra e vizitave që bëhen deputetët.. Vizitat e deputetëve jo gjithëherë ka qenë të duhura në pjesëmarrjen e tyre në forume apo konferenca, që nuk ndërliiden me funksionet që i kanë në Kuvend.

**Ali Lajçi:** Ajo që është më e rëndësishme të analizohet dhe të diskutohet është fakti se si po shpenzohen mjetet, nëse kemi vizita dhe agjenda të domosdoshme. Duhet shikuar edhe procedurat për shpenzimin e këtyre mjeteve. Çështja tjetër kur udhëton delegacioni duhet definuar numrin e stafit përcjellës dhe jo të lihet e hapur.

Te subvencionet shpesh ka ndodhur që disa projekte mos të realizohen fare sipas procedurave apo konkurseve. Janë dhënë disa raporte por jo të mjaftueshme, se e ka mbet buxhet ose është shpenzuar buxhet më vonë këto duhet të kryhen proceduralisht?

**Safete Hadergjonaj:** Dua të falënderoj Administratën e Kuvendit që çdo herë Komisionit për buxhet dhe financa ja ka ofruar një raport të detalizuar të shpenzimeve dhe kisha pasur dëshirën e madhe që një raporti i tillë i detalizuar të përgaditje edhe nga të gjitha institucionet tjera dhe ato që raportojnë në Kuvend. Kuvendi është institucion reprezentativë dhe ne kemi qenë dëshmitarë gjatë vitit të kaluar se kemi pas një lëvizje më të madhe nga Kryetari i Kuvendit dhe deputetëve për lobim dhe këto vizita

kanë qenë të mira e të vlefshme për shtetin tonë. Unë e kuptoj edhe qëndrimet e opozitës, por nuk është mënyrë që të bëjnë reagime kritikuese në atë masë sa ta qesim poshtë edhe kredibilitetin e institucionit të Kuvendit. Të gjitha vizitat që i ka bërë Kryetari i Kuvendit kanë qenë publike dhe përmes mediave, përfshirë natyrën e diskutimeve në interes të lobimit për interesa të vendit.

Ajo që më bënë përshtypje pozitive miratimi i Rregullores për subvencione dhe realizimi i këtyre shpenzimeve bazuar në këtë rregullore, që është një problem që jo të gjitha institucionet tjera kanë të nxjerra rregullore të posaçme për subvencione. Është për tu përgëzuar adresimi i të gjitha rekomandimeve të auditorit.

Duke shikuar raportin, tek udhëtimet jashtë vendit, zakonisht janë disa deputetë të cilët janë gjithmonë në rrugë. Edhe ne na vijnë ftesa për këso lloje vizita dhe mundemi me marrë pjesë, mirëpo duhet të ketë një arsyeshmëri dhe kuptim pjesëmarrje në këto vizita.

Neve si deputetë na është krijuar mundësia që ti kemi disa këshilltar në grupet parlamentare, por probleme që po vazhdon që nga themelimi është mungesa e zyrave për deputetë, që nuk po kemi hapësire as ku ti lëmë materialet. Është mirë me e pas raportin për tre mujorin e fundit, por kur shënon Raporti i shpenzimeve të vitit 2018, duhet me qenë të dhënat në detale për gjithë vitin.

**Kryetari:** Theksoi se meqë po shqyrtojmë raportin vjetor të shpenzimeve do të duhej të ishin të prezantuara në detale të dhënat për gjithë vitin dhe jo vetëm për tremujorin e fundit. Prandaj, të bëhet praktikë që të dhënat të jenë vjetore.

**Ismet Krasniqi:** Më vjen mirë që ka kaq vëmendje Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës sepse ka të bëjë edhe mu ju si deputet por edhe me neve si administratë dhe mendojë që është mirë që raportet e Kuvendit të jenë një pikë e veçantë kur të shqyrtohen në komision. Raportet e shpenzimeve, përfshirë edhe ato tremujore i publikojmë në ueb faqen e Kuvendit dhe ne kemi prezantuar të dhënat e tremujorit të fundit në mënyrë që me pas mundësi me bë krahasime. Por sipas kërkesës tuaj, do ti keni të dhënat e kompletuara për vitin 2018. Raporti i shpenzimeve është i detalizuar dhe për të gjitha shpenzimeve ekzistojnë vendimet. P.sh., rasti i shpenzimeve të karburantit për vetura ne regjistrujmë çdo litër të shpenzuar dhe emrat e personave që i kanë shpenzuar. Po ashtu për servisimin e automjeteve, për mirëmbajtje.

**Dardan Molliqaj:** Një çështje tjetër është rrjeti i internetit shumë i dobët dhe nuk po funksion. Kam një kërkesë që ta merrni seriozisht me rregullue këtë çështje sepse është shumë me rëndësi për punë. E dyta jam duke bërë një hulumtim ku është caktuar vetëm një kompani në nivel qendror që ofron bileta për udhëtime, deri dhjetë fish më të shtrenjta se çmimi i tregut. Kjo është skandal dhe këtë kam me e ngritur në Kuvend. Do të duhet që minimalisht ti kemi tri kompani që ofrojnë këto shërbime të biletave.

**Safete Hadergjonaj:** Theksoi se shumë mirë e ngriti Dardani problemin me rrjet sepse në seancë nuk po mund të kyçemi në internet për shkak rrjetit të dobët, prandaj duhet adresohet kjo çështje shpejtë. Lidhur me çështjen e biletave është e vërtet për çmimet më të shtrenjta të biletave që ofrohen dhe na ka ndodhur disa herë me i ndërru dy apo tre aeroplan për të arritur në vendin e caktuar dhe këtu duhet gjetur zgjidhje dhe duhet diskutuar me Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQF) që bënë prokurimet e centralizuara.

**Ismet Krasniqi:** Sa i përket rrjetit në përzgjedhjen që kemi bërë si prokurim do kalojë shumë shpejtë dhe brenda muajit do të rregullohet çështja e rrjetit për komplet ndërtesën. Për biletat e udhëtimeve është përgjegjësi e AQF-së në kuadër të prokurimeve të centralizuara dhe ajo ka përcaktuar kriteret në bazë të së cilës është përzgjedhur operatori ekonomik për ofrimin e biletave të udhëtimit dhe ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në këtë proces.

**Mergim Lushtaku:** Theksoi se vërejtjet e mia janë të njëjta me shumicën e deputeteve e sidomos me ato që ngritën znj. Hadergjonaj dhe z. Kuqi që raportit është dashur të na vie si raport total i vitit dhe për shpenzimet për 12 muaj. Është mirë që të shikohen të gjitha shpenzimet dhe ato të jenë minimale të jetë e mundur, mirëpo për pozitën e Kryetarit të Kuvendit, duhet pasur konsideratë pasiqë ai përfaqëson Kuvendin dhe për të gjitha vizitat e realizuar dhe të miratuara në Kryesi, besojë se kanë pasur arsyeshmërinë e tyre, dhe ne duhet të shikojmë dhe vlerësojmë edhe përmbajtjen e tyre dhe jo vetëm shumat e shpenzuara.

Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të deputetëve, si kryetar i Grupit të Miqësisë kam bërë një kërkesë që 5 deputetët të Grupit të Miqësisë të realizojmë një vizitë në Podgoricë tek Ambasada e Emirateve të Bashkuara Arabe, por fatkeqësisht nga pesë deputetë, kam shkuar vetëm unë. Unë mendojë se kur të bëhet kërkesa për vizitë duhet shkuar sepse dalim joserioz në përfaqësimin e shtetit dhe institucionit.

Sa i përket digjitalizimit të administratës publike mua më vjen mirë që keni pas një progres në këtë drejtim, dhe e dinë mirë se edhe në vitin e kaluar kam qenë kritik në këtë pikë dhe duhet të digjitalizohet salla plenare dhe sallat e komisioneve, që të mund të kemi qasje në materialet dhe dokumentet që janë në interes të punëve në Kuvend dhe do të ishte më mirë që të kemi llap topin në sallë të instaluar dhe mos të marrim fare me vete.

**Enver Hoti:** E kuptojë se të gjitha shpenzimeve janë bërë në bazë të vendimeve. Por neve na intereson më shumë qëllimi dhe përmbajtja e vendimeve. Pra, neve na intereson me pa arsyeshmërinë e vendimeve të marra.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi në bazë të rezultatit të votimit: 5 vota Për, Asnjë Kundër dhe Asnjë Abstenim, Komisioni nuk pati kuorum për vendimmarrje dhe votimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018, shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

**Kryetari:** Theksoi se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit, Kryetari konstatoi në bazë të rezultatit të votimit: 5 vota Për, Asnjë Kundër dhe Asnjë Abstenim, Komisioni nuk pati kuorum për vendimmarrje dhe votimi i Projektligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:05.**

**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Kryetari komisionit,**

-----  
**Lumir Abdixhiku**